



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.5/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Delushe Halimi dhe Ragip Namani anëtarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj A. T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P. – Dega në K., për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së gjyqtarit, paraqitur kundër Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK. nr.439/2024 datë 26 dhjetor 2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 31.01.2025, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e A. T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P. – Dega në K., paraqitur kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës - KGJK nr.439/2024 dt.26 dhjetor 2024.

### A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.439/2024 dt.26.12.2024, A. T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P. - Dega në K., është gjetur përgjegjës për shkelje disiplinore sipas nenit 5, par.2 , nënp.2.15 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, për këtë shkelje disiplinore sipas pikës I të dispozitivit të vendimit, gjyqtarit A. T. i shqiptohet sanksioni disiplinor vërejtje jopublike me shkrim.

Kundër këtij vendimi gjyqtari A.T., në afat ligjor, ka paraqitur ankesë, për shkak shkeljes së dispozitave procedurale dhe materiale të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljes procedurale të përcaktuar me ligj, si dhe gabimit faktik të qartë apo të dukshëm, i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës, me propozim që, të aprovohet në tërësi si e

bazuar ankesa e gjyqtarit, dhe të ndryshohet vendimi i goditur i KGJK-së, i sipër përmendur apo ta kthejë në Këshill për rishqyrtim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) nëpërmjet të cilës kundërshton thëniet ankimore, me propozim që, ankesa të refuzohet dhe vendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të vendimit të goditur, në kuptim të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe shkresave të lëndës si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesë, gjeti se,

Ankesa e Gjyqtarit A. T., është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datën 30 gusht 2024, ka pranuar kërkesë të evidentuar GJS-2024-011 nga Autoriteti Kompetent i Gjykatës Supreme të Kosovës për fillimin e hetimit disiplinor ndaj A. T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë - Dega në K., me pretendim se i njëjti mund të ketë kryer shkelje disiplinore të përcaktuar në nenin 5, par.2, nënp.2.15 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Autoriteti Kompetent, bazuar në faktet e prezentuara në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor, ka konsideruar se subjekti i hetimit disiplinor, më dt.25.07.2024 kishte dërguar email në adresën e kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, Armend Berisha, përmes të cilit ishte deklaruar lidhur me pëlqimet e kryetarit Armend Berisha për dy transfere të gjyqtarëve ku ishte shprehur se ato transfere “ janë të përçudshme, jo të drejta, jo parimore dhe të kundërligjshme”. Në email subjekti i hetimit kishte shtuar tutje se “ me përcaktimet e tilla me pëlqim, sa që po e pyes veten! Nuk po e di se çka përfaqësoni ju : padrejtësi, trajtim të privilegjuar të disave, në njërën anë apo keni për mision drejtësinë, trajtimin e barabartë të gjyqtarëve, kryetar i të cilit jeni, në anën tjetër!. Deri më tani kam qenë i bindur se jeni rreshtuar në këtë të dytën, por tani nuk jam i sigurt, sepse kam humbur besimin në ju”. Autoriteti Kompetent pasi ka filluar hetimin preliminar ka kërkuar deklaratë nga subjekti i hetimit dhe i njëjti ishte deklaruar në të njëjtën mënyrë dhe shprehje të njëjta, të përshkruara si më lartë. Pas pranimit të kërkesës për fillim të hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent, në mbledhjen e mbajtur më dt.12.09.2024, me vendimin e KGJK-së,nr.343/2024, Këshilli ka themeluar panelin hetimor, vendim i cili është plotësuar e ndryshuar me një vendim tjetër të Këshillit KGJK.nr.360/2024 dt.30.09.2024.

Paneli hetimor pas zhvillimit dhe përfundimit të procedurave përkatëse ka dorëzuar raportin me shkrim lidhur me gjetjet, faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit të bërë për shkeljen disiplinore të pretenduar ndaj gjyqtarit A. T. KGJK ka mbajtur seancën dëgjimore më dt.26.12.2024, me ç rast kryesuesi i panelit hetimor deklaroi se si panel e kanë zhvilluar fazën e hetimit duke respektuar LPDGJP-së, dhe Rregulloren 05/2029 për Procedurën disiplinore të gjyqtarëve, dhe ka shtuar se paneli hetimor duke u bazuar në deklaratën e dhënë të subjektit hetimor, tek Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, ku i njëjti më dt.25.07.2024 ka theksuar se ia ka shprehur në email Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë Armend Berisha, pakënaqësinë e tij lidhur me transferet e lejuara nga kryetari, të cilat ai i ka cilësuar “ si të përçudshme, jo parimore, jo të drejta dhe të kundërligjshme”, si dhe fjalët tjera më sipër të përshkruara, duke theksuar më tej, se me këto transfere nuk është respektuar parimi i së drejtës që lidhet me barabarësinë, mos diskriminimin si dhe nuk janë respektuar kriteret dhe kushtet për pëlqim dhe se teksti i emailit të sipër cekur nga gjyqtari, subjekt i hetimit, janë fakte të pa kontestueshme, ndaj, paneli hetimor e ka konsideruar si shprehje ofenduese dhe fyese të subjektit hetimor A. T., dhe të drejtuara kundër Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, e që bien ndesh me Ligjin për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe raportin me shkrim, për të gjeturat përkatëse, ia kanë dorëzuar Këshillit, si Autoritet Kompetent për vlerësimin nëse subjekti hetimit me veprimet e tija ka kryer shkeljen disiplinore të pretenduar nga Autoriteti Kompetent – Kryetari i Gjykatës Supreme.

Subjekti i hetimit ka deklaruar, veç tjerash, se është e vërtetë se i ka dërguar email Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë Armend Berisha, me të cilën ka shprehur në mënyrë të sinqertë pakënaqësinë e tij lidhur me transferimet e lejuara nga ai dhe se me njërin transfer është prekur drejtpërdrejtë interesi i tij, ndaj, lidhur me këtë, është shprehur me fjalët e sipër cituara.

Këshilli, për ti vërtetuar faktet në çështjen përkatëse disiplinore, administroi dhe vlerësoi provat si : Raportin hetimor mbi faktet dhe provat e mbledhura, Akti përcjellës i Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Rexhepi, për pranimin e njoftimit nga Kryesuesi i KGJK-së, sa i përket ankesës ndaj gjyqtarit T., të dt. 25.07.2024, Kërkesa për fillimin e hetimit, disiplinor GJS e paraqitur nga Autoriteti Kompetent, Emaili i Kryesuesit A.Zogaj, drejtuar Kryetarit GJSK Fejzullah Rexhepit, dt.25.07.2024, deklarata e subjektit të hetimit 5.08.2024, Emaili i subjektit të hetimit drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë 26.08.2024,, vendimet për themelimin e panelit hetimor të GJSK, Procesverbali i panelit hetimor i dt.24.10.2024 dhe ai i dt.5.11.2024,

Transkripti i seancës dëgjimore e panelit hetimor të mbajtur më dt.25.11.2024, Emaila të panelit hetimor për koordinim të veprimeve dhe veprimet tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Në fjalën përfundimtare Kryesuesi i panelit hetimor deklaroi se subjekti i hetimit gjyqtari A. T., përmbajtjen e emaili kontestues drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në P., nuk e ka kundërshtuar në asnjë fazë të procedurës. Subjekti i hetimit gjyqtari A. T., në fjalën përfundimtare deklaroi se kërkesa e Autoritetit Kompetent për fillim të hetimit duhet të hedhet poshtë si e pas afatshme ose të refuzohet si e pa bazuar dhe të lirohet nga përgjegjësia disiplinore.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe të deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli ka konstatuar se nuk qëndron pretendimi i subjektit të hetimit se kërkesa për fillim të hetimit disiplinor e paraqitur në Këshill, nga Autoriteti Kompetent i Gjykatës Supreme të Kosovës është e pas afatshme dhe kjo është vërtetuar me provat që janë gjendur në shkresat e lëndës. Këshilli, bazuar në prova, vërtetoi se veprimin e parë Autoriteti Kompetent e ka ndërmarr me kërkesën për dhënie të deklaratës nga subjekti i hetimit të cilën e ka dërguar më dt.30.07.2024, ndërsa, kërkesën për fillim të hetimit Autoriteti Kompetent e ka përpiluar më dt.26.08.2024, ndërsa, Këshilli e ka pranuar më dt.30.08.2024, që do të thotë brenda afatit 30 ditor siç është përcaktuar me nenin 9 par.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ndërkohë që, lidhur me transferimet në fjalë dhe shprehjet e përdorura nga subjekti i hetimit, Këshilli i ka konsideruar si shprehje fyese, ofenduese ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë dhe me këto sjellje dhe veprime subjekti i hetimit ka dëmtuar reputacionin e gjykatës, nga se gjyqtari duhet të sillet me integritet, si në jetën profesionale ashtu edhe në jetën personale dhe me sjelljet e tij në gjykatë dhe jashtë saj ruan dhe avancohet besimin e publikut, nuk duhet të përdorë gjuhën e papërshtatshme, të ketë sjellje të pahijshme apo të vrazhdë, që në këtë rast gjuha e përdorur e ka tejkaluar lirin e shprehjes, pasi kemi të bëjmë me denigrim dhe sulm ndaj vlerave personale të personit tjetër, në rastin konkret të kryetarit të gjykatës. Prandaj, Këshilli ka konstatuar se subjekti i hetimit gjyqtari A. T., ka konsumuar shkelje disiplinore të përcaktuar me nenin 5, par.2, nënp.2.15, përfshihet në sjellje qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Shkeljet e sipër theksuara janë provuar me provat e administruara, të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës i panelit hetimor, i cili është vlerësuar si objektiv dhe i besueshëm. Masa disiplinore, vërejtje jopublike me shkrim, e shqiptuar në mënyrë unanime, sipas Këshillit, është proporcionale me

shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit dhe e cila do të ndikoi tek gjyqtari që është subjekt i hetimit me qëllim të korrektimit të veprimeve të tij gjatë ushtrimit të funksionit në të ardhmen.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes disiplinore, Gjykata Supreme e Kosovës, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e tij, i cili nuk është i përfshirë me zbatim të gabuar të ligjit dhe as me shkelje të dispozitave procedurale të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, si dhe drejtë ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të tij. Ndaj, nga arsyet e sipër cekura, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është përfshirë me shkeljet e pretenduara si në ankesë. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, dispozitivi i vendimit të goditur është i qartë, në harmoni me arsyet e vendimit, duke qenë kështu në përputhje logjike dhe juridike edhe arsyetimi, me dispozitivin. KGJK, ka dhënë të gjitha arsyet për faktet relevante për vendosje të drejtë dhe të plotë, në kontekst dhe përkitazi me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit A. T., duke bërë kështu vlerësimin e të gjitha rrethanave dhe vërtetimin e të gjitha fakteve me rëndësi për çështjen konkrete, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë nga e cila ka konstatuar përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit të iniciuar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe ia ka shqiptuar masën përkatëse të sanksionit disiplinor.

Gjykata Supreme e Kosovës, e miraton edhe qëndrimin se masa disiplinore e shqiptuar, nga KGJK, është proporcionale në raport me shkeljen e kryer nga ana e subjektit hetimor dhe është në zbatim të përgjegjësive ligjore që ka KGJK në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Gjykata Supreme vlerëson se janë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 15 të Ligjit, që rregullojnë çështjen e ankimit ndaj vendimeve të KGJK-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe pika 4 e këtij neni parasheh se ankesa ndaj vendimeve të KGJK-së mund të ushtrohet në rast të zbatimit të gabuar të ligjit,( 4.1), në rast të shkeljes procedurale të përcaktuar me ligj,( 4.2) dhe në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës ( 4.3 ), gjë që, në rastin konkret nuk është provuar se ka ndodhur.

Në këtë gjendje të çështjes juridike – disiplinore, bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e vendimit të KGJK-së, Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se ankesa dhe pretendimet në të,

të subjektit hetimor, që janë paraqitur ndaj vendimit të KGJK-së, nuk mbështeten në fakte dhe prova përkatëse. KGJK, ka vepruar në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka argumentuar se është bërë shkelje disiplinore nga paraqitësi i ankesës, i ka shqiptuar masën disiplinore në harmoni me parimin e proporcionalitetit dhe të kriterëve të parapara ligjore (neni 7 par.2) dhe ka marrë parasysh, pra, edhe seriozitetin, pasojat, rrethanat në të cilat është kryer shkelja etj, ndaj, nga këtu, pretendimet e ankesës për aplikim të gabuar të dispozitave ligjore dhe të së drejtës materiale janë të pathemelta dhe si të tilla janë të pa qëndrueshme juridikisht.

Prandaj, nga këtu, sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, sanksioni disiplinor i shqiptuar nga KGJK, (vërejtje jopublike me shkrim) është në përputhje me shkeljet e gjetura në Raportin e Panelit hetimor si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 7 par. 1 nënp.1.1 dhe par. 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ndaj, nga këtu pretendimet ankimore lidhur me këtë çështje juridike – disiplinore u refuzuan si të pa themelta, për faktin sepse nuk u provua se në rastin konkret është bërë zbatim i gabuar i ligjit, as shkelje procedurale të përcaktuar me ligj dhe as ndonjë gabim i qartë apo i dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës... sikundër parashihet me dispozitat e nenit 15 par.4 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga arsyet e sipër përmendura dhe në mbështetje të dispozitës të nenit 15.6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.5/2025 dt. 31.01.2025

Kryetari kolegjit,

Mr.Sc.Muhamet Rexha

